



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 764 prot.

Roskovec, më 30.01.2025

VENDIM

NR 7. DATË 29.01.2025

“PËR MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT, PËR PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; të shkresës Nr.741 prot. datë 12.01.2024 “Mbi Fondet për programet e strehimit 2024” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Udhëzimit Nr.31, datë 18.11.2019, “Për Procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit” referuar Ligjit Nr. 22/2018 "Për strehimin social" të ndryshuar; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë bashkëfinancimin prej 50% për programin:

- *“Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2025-2026”*

Vlera e plotë e projektit është: **9 999 860 lekë me TVSH**, nga e cila **50% financohet nga Bashkia.**

Bashkia Roskovec merr përsipër të financojë 50% të vlerës së plotë të projektit konkretisht 4 999 930 lekë me TVSH “ Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

2.Ngarkohet Komisioni i Strehimit për kryerjen e procedurave përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

